



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës  
Opština Prištine -Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 2.2, pika c e Ligjit nr. 03/L- 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 9 të Ligjit 03/L-49 për financat e pushtetit lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 27/2008), të nenit 9 të Ligjit nr. 06/L-005, për tatimin në pronën e paluajtshme ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 2/15, shkurt 2018") të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja c e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 -391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.11.2021, miratoi këtë:

**VENDIM  
PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE TË TATIMIT NË PRONËN E  
PALUAJTSHME PËR VITIN 2022**

**Neni 1  
Normat tatimore**

Në bazë të Ligjit nr. 06/L-005, për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi i Komunës së Prishtinës cakton normat tatimore për vitin 2022, për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë "pronë publike", si vijon:

- Për njësitë bujqësore të parcelave-----0.15%
- Për njësitë bujqësore të objekteve-----0.15%
- Për njësitë pyjore të parcelave-----0.15%
- Për njësitë rezidenciale të parcelave-----0.15%
- Për njësitë rezidenciale të objekteve----- 0.15%
- Për njësitë komerciale të parcelave-----0.17%
- Për njësitë komerciale të objekteve-----0.17%
- Për njësitë industriale të parcelave-----0.17%
- Për njësitë industriale të objekteve-----0.17%

**Neni 2**  
**Aktet e vendimit**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për Komunën e Prishtinës, 09. nr. 378, dt. 31.10.2019 dhe Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për prona komerciale dhe industriale për Komunën e Prishtinës, 09. nr. 432, dt. 30.10.2020, si dhe Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për prona bujqësore dhe pyjore për Komunën e Prishtinës , 09/463, nr. 295/2021, dt.29.10.2021, të nxjerra nga Ministria e Financave.

**Neni 3**  
**Zbatimi**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria e Financave, përkatësisht Sektori i tatimit në pronë, dhe fillon të zbatohet nga dt. 01.01.2022.

**Neni 4**  
**Shfuqizimi**

Ky vendim shfuqizon Vendimin për tatim në pronën e paluajtshme, 01-431/03-4399/21, dt. 11.01.2021.

**Neni 5**  
**Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-431/03-245451/21, më 12.11.2021

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta



## ARSYETIM

Në zbatim të nenit 9 të Ligjit nr. 06/L-005, për tatimin në pronën e paluajtshme, parashihet që Kuvendi komunal i secilës komunë të caktojë normat tatimore për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike.

Në nenin 1 të këtij vendimi kemi vendosur normat tatimore për kategoritë e pronave rezidenciale, komerciale, industriale dhe bujqësore, dhe për njësitë e parcelave rezidenciale, komerciale, industriale dhe bujqësore.

Vlerësimet e pronave të paluajtshme për njësitë: bujqësore të parcelave, bujqësore të objekteve, pyjore të parcelave, rezidenciale të parcelave, komerciale të parcelave dhe industriale të parcelave, janë caktuar sipas Raportit të vlerësimit të përgjithshëm për Komunën e Prishtinës, 09/463, nr. 295/2021, dt. 29.10.2021.

Vlerësimet e pronave të paluajtshme për njësitë rezidenciale të objekteve, që përfshinë kategorinë e vlerës për apartament, shtëpi familjare, garazhe për shfrytëzim privat dhe objekt tjetër rezidencial, janë caktuar sipas Raportit mbi vlerësimin e përgjithshëm për Komunën e Prishtinës, 09. nr. 378, datë 31.10.2019.

Vlerësimet e pronave të paluajtshme për njësitë, parcelë komerciale të tokës komerciale që përfshinë kategorinë e vlerës për parcelë për objekt komerciale, parcelë për rekreacion komercial dhe parcelë për transport komercial, si dhe njësitë e objekteve komerciale që përfshinë: kategorinë e vlerës për shitore, zyrë, restorant, hotel, objekt për magazinim komercial, garazh komercial, pishinë për shfrytëzim komercial, fushë e hapur sportive, fushë e mbyllur sportive, pompë benzine dhe objekt tjetër komercial.

Vlerësimet e pronave të paluajtshme për njësitë parcelë industriale të tokës industriale, që përfshinë kategorinë e vlerës për parcelë për industri, parcelë për impiant elektrik dhe parcelë për veprimtari nxjerrëse, si dhe njësitë e objekteve industriale, që përfshinë kategorinë e vlerës për fabrikë, punishte, objekt për magazinim industrial dhe objekt tjetër industrial, që janë të caktuar sipas Raportit mbi vlerësimin e përgjithshëm të pronave komerciale dhe industriale për Komunën e Prishtinës, 09. nr. 432, dt. 30.10.2020. Të tri raportet e cekura më lart janë të nxjerra nga Ministria e Financave, si autoritet kompetent për zbatimin e procedurës së vlerësimit, në përputhje me Kapitullin V, nenin 17 të Ligjit nr. 06/L-005.

Andaj, Drejtoria e Financave ka hartuar këtë propozimvendim dhe propozon që të miratohet në seancën e radhës të Kuvendit të Komunës.